



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 183/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Rahovec, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), ndërsa Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dega në Rahovec i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 900 (nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 05.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje dega në Rahovec, në të cilën theksohet se me datën 05.06.2014 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, konkretisht aktivisti Azbi Gashi rreth orës 14:00 ka vërejtur se mbi rrugë publike konkretisht në rrugën Xhelal Hajda - Toni në Rahovec ishte vendosur baneri i kandidatëve për deputet nga rradhët e AAK-së Ramush Haradinaj, Smajl Latifi, Luan Jaha dhe Florije Boshnjaku. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim AAK ka bërë shkelje të Nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 ku me këtë dispozit ndalohet vendosja e posterëve mbi rrugë publike. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, me datë 07.06.2014 e informoi subjektin politik, AAK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në kërkesë Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 07.06.2014, në ora 19:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me të cilën theksohet se vendosja e banerit mbi rrugë publike të Kandidatëve të AAK-së, nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së, dhe se vendosja e banerit në fjale mund të jete bërë nga qytetar apo individ të pa identifikuar. Andaj me këtë rast AAK konfirmon se me të pranuar njoftimin për ankesën në fjalë ka kontaktuar strukturat e saj në Rahovec dhe ka bërë heqjen e banerit nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Si dëshmi për këto AAK përgjigjes në Ankesë i ka bashkangjitur: Udhëzimin e kryetarit të AAK-së z. Ramush Haradinaj drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregulloreve të KQZ-së të datës 30.05.2013, fotografit me të cilat dëshmohet largimi i banerit si dhe kërkesën drejtuar shefave të Shtabeve Zgjedhore dhe Kandidatëve për respektim të Kodit të Mirësjelljes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se në komunën e Rahovecit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka vendosur mbi rrugë publike banerin me kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik janë të qëndrueshme ngase kjo vërtetohet nga fotografia e cila gjendet në shkresat e lëndës veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33.1 pika b) të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se baneri i kandidatëve për deputet ka qenë i vendosur mbi rrugë publike, ndërsa si rrethanë tjetër rënduese mori atë që subjekti politik AAK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se AAK, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se "*Është e ndaluar të vendosen posterat apo pllakatat në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore*", andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 183/2014 më datën 08.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*